Ju keni marrë një letër rreth Arsimimit të Nxënësit në Anglisht (ELE). Çfarë vjen më pas?

Ju keni marrë një letër nga distrikti shkollor, sepse familja juaj flet një gjuhë tjetër në shtëpi e cila është e ndryshme nga anglishtja. Fëmija juaj mund të kualifikohet për Arsimimin e Nxënësit në Anglisht (ELE).

1

Distrikti shkollor teston aftësitë e fëmijës suaj në anglisht. Kjo përfshin:

- leximin
- shkrimin
- dëgjimin
- të folurën



Nëse fëmija juaj kualifikohet, distrikti shkollor do ju dërgojë rezultatet e testit të tyre.

Ata do të rekomandojnë gjithashtu implementimin e një programi të Arsimimit të Nxënësit në Anglisht (ELE) në shkollë.

2

Ju keni zgjedhje të ndryshme. Mësoni rreth të drejtave dhe mundësive tuaja.



Ja ç'mund të bëni!

- Vizitoni programet e disponueshme.
- Merrni pjesë në takime dhe konferenca rreth Arsimimit të Nxënësit në Anglisht (ELE).
- Zgjidhni një vendosje tjetër të disponueshme.

3

Nëse fëmija juaj është në një program të Arsimimit të Nxënësit në Anglisht (ELE), shkolla do të testojë rregullisht aftësitë e fëmijës suaj në anglisht për të zbuluar nëse ai/ajo është gati të dalë nga programi.


Si nxënës i suksesshëm shumëgjuhësh, ai/ajo mund të fitojë një çmim, Vulën e Shtetit për Dygjuhësinë.

Ju dhe shkolla jeni partnerë në arsimimin e fëmijës suaj.

Le të punojmë së bashku për të shtuar suksesin e nxënësit tuaj!

Ja disa hapa të tjera në vazhdim:

- Njihuni me mësuesit dhe personelin
- Mësoni rreth Vulës së Shtetit për Dygjuhësinë
- Bëni pyetje dhe ndani informacion
- Përfshihuni në Komitetin Këshillimor të Prindërve për Nxënësit në Anglisht (ELPAC)



Ky burim u zhvillua për Departamentin e Arsimit Fillor dhe të Mesëm në Masaçusets nga Qendra Shtetërore për Angazhimin Familjar në Masaçusets, një program i Federatës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta.

A keni pyetje? Kontaktoni shkollën tuaj: